



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:220104

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05829052

Ac.nr.843/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: S.H nga fsh....., M..... të cilin tani sipas autorizimit e përfaqëson Rifat Bllata avokat në Vushtrri, kundër të paditurës: Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A – Divizioni i Rrjetit – Prishtinë te cilën e përfaqëson Shukrije Ternava sipas autorizimit me shkrim, për kompensimin e dëmit material duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të paditurës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.101/2019, i datës 29.12.2020, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 11.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës: Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A– Divizioni i Rrjetit – Prishtine, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.101/2019, i datës 29.12.2020 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.101/2019, i datës 29.12.2020 ka vendosur si në vijim:

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit; S.H nga fsh....., M..... dhe DETYROHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. – Divizioni i Rrjetit ne Prishtine – Distribucioni ne Mitrovice qe paditësit në emër të demit material te pësuar ne shtëpinë e tij ne Sh....., M..... ne dt.13.04.2008 nga shpërthimi i zjarrit prej energjisë elektrike ti paguaj shumen e tërësishme prej 210.389.00 € , me kamate vjetore 8% , duke filluar nga dt.30.01.2020 e gjere ne pagesën definitive, te gjitha këto ne afatin prej 15 ditëve nen kërcënimin e përbarimit te detyruar.

Detyrohet e paditura qe paditësit ti kompensoi shpenzimet e procedurës kontestimore ne shume prej 2.194,00 €,ne afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e paditësit si e bazuar

dhe gjykata e shkallës së dytë ta prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë apo ta ndryshoj lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur e paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 25.02.2019, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës, të precizuar si në parashtresën e datës 06.04.2020, me të cilin ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit si e bazuar dhe të detyrohen e paditura Korporata Energetike e Kosovës sh.a. në Prishtinë, që paditësit për dëmin material të pësuar për shkak të shpërthimit të zjarrit në shtëpinë e paditësit me dt.13.04.2008, t'ia kompensoi demin dhe atë : për objektin - shtëpinë ne shumen prej 52.155,00 € si dhe ne mallin e shkartuar si teknik e bardhe, veshmbathje elektronik, orendi te specifikuar në ekspertizën financiare ne vlere prej 158.234,00 €, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit te të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.101/2019, i datës 29.12.2020, me të cilin ka aprovuar në tersi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Nga Raporti i Policisë numri i rastit 2008-BI-90 i dt.13.04.2008 konstatohet se: me dt. 13.04.2008 ne rr.,, Dëshmoret e Kombit ne Sh..... ka ndodhur një rast zjarri ku ne vendin e ngjarjes kane qene njësia e KEK-ut, njësia e Zjarrfikësve, KFOR-i Franqez , eksperti i elektron A.Nsi dhe i dëmtuari S.H dhe se me këtë rast është shkaktuar dem material në shtëpinë e paditësit. Nga aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Mitrovice PP.II.nr.1325/18 e dt. 10.01.2019, konstatohet se : kundër H.Xh. dhe E.Q.është ngritur aktakuze për shkak te vepres penale shkaktimi i rrezikut te përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 4 lidhur me par.1 KPRK, per shkak se me dt. 13.04.2013 ne Mitrovice ne lagjen e Sh.....it me një veprim te rrezikshëm kane shkaktuar dem te konsiderueshëm te pasurisë, ashtu qe si punëtor te KEK-ut , pasi qe konsumatori S.H kishte kërkuar intervenimin e KEK-ut për rregullimin e sistemit elektrik trefazor sepse ne shtëpi nuk kishte funksionuar një faze. Punëtorët e lartcekur te KEK-ut – gje gjësisht te pandehurit ne ditën kritike intervenojnë ne sanimin e këtij problem port e njëjtit nuk tregojnë kujdes te shtuar gjate intervenimit ne fashën lidhëse, te njëjtat nuk i kryqin ne mënyrë adekuate ku pastaj si rezultat i kontaktit te keq ne fishat lidhëse vjen deri tek rritja e rezistences kurse kjo ritje e rezistences shkakton zjarr dhe si pasoj e kësaj digjen mibilet brenda shtëpisë se S.Hkryesisht teknika e bardhe si dhe një pjese e shtëpisë duke shkaktuar demi ne vlere prej 65,000 euro, pastaj zjarri përhapet dhe dëmton pjesën e shtëpisë se B.Hi cili shkaktohet demi ne vlere prej 262.101,00 euro e pastaj zjarri e dëmton shtëpinë e te dëmtuarit S.Kte cilit i djegën dritaret e shtëpisë, garazhe e automjetit dhe brendësia e shtëpisë ne tërësi ku vlere e demit te shkaktuar është 40.000,00 euro .

Tutje gjykata ka shtuar se nga ekspertiza e ekspertit A.N.inxh i elektros i dt. 06.05.2008, konstatohet se: ngjarja ka ndodhur me dt. 13.04.2008 ne ora 15:30, i shoqëruar me policin hetues B.Sdhe ate te forenzikes F.Fsi dhe Prokurorin e Qarkut Sh.Sdhe ky ekspert ka ardhë ne konstatim se nga shikimi i bere ne vendin e ngjarjes e duke e marre parasysh se ekzekutimi i instalimit ne objekt ka qene i kryer ne mënyre profesionale, duke filluar nga shtylla me kabell nëntokësor e duke vazhduar me KPO-N e cila ka qene e pajisur me siguresa thikore, konstatoj se zjarri se pari është paraqit ne Bornet e njehsorit elektrik trefazor dhe nga aty është përhapës

ne drejtime te ndryshme. Kontakti jo i mire ne Borne shkakton rritjen e rezistencës dhe kjo rritje e rezistencës është burim i shkëndijës se pare te zjarrit ne lokalin e lartcekur . Ne baze te analizave te mia nuk kam gjetur shkaktar tjetër te zjarrit ne këtë objekt. Nga ekspertiza e ndërtimtarisë – eksperteve L.D.inxh. I ndërtimtarisë dhe H.M.vlerësues i palujtshmerise konstatohet se : demi i shkaktuar nga zjarri ne objektet e paditesit eshte ne vlere prej 52.155,00 euro dhe se kjo vlere është për kohen e ndodhjes se rastit me dt. 13.04.2008 ku struktura e konstrukcioneve ndërtimore te betonit, kulmit, mureve, dyshemesë etj, janë te dëmtuara duke i marre ne konsiderate nga temperaturat e zjarrit qe kane deformuar edhe armaturën dhe shtresën mbrojtëse te beton armës dhe se ky vlerësim është llogaritur si kosto ndërtimi e vlerës ne treg vetëm për ndërtimin e objektit ndërtimor te katit te pare , katit te dyte , kulmit ndërsa përdhese mund te sanohet dhe është kryer nga pronari . Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit financiar Mr.Sc.M.F.e dt. 17.02.2020, konstatohet se vlere e kompensimit te demit te shkaktuar me rastin e aksidentit nga KEDS-i, si pasoj e zjarrit ne gjësendet – mallit e tani prone te paditesit është ne shume të tërësishme prej 158,234,00 euro.

Gjykata e shkalles së parë ka shtuar se nga provat e sipërcekura u vërtetua se ne shtëpinë e paditësit ne Sh..... te M..... kishte shpërthyer zjarri dhe pas pranimit te informatës njësiti hetimor i Policës se Kosovës, se bashku me zjarrfikësit, Prokurorin e Gjykatës se Qarkut ne Mitrovicë dhe ekspertin e pavarur te energjetikes A.NIngj.Dip.Elek, kishin dalur ne vend te ngjarjes dhe kane konstatuar se është djegur shtëpia e paditësit si dhe gjësendet duke filluar nga veshmbathjet ,teknika e bardhe orenditë etj. Nga ekspertiza e ekspertit te elektros e sipër cekur me pamedyshme u argumentua baza e kërkesëpadisë nga se nga i njëjti ekspert u argumentue se gjere te shkaktimi i zjarrit ka ardhur për shkak te kontaktit jo te mirre ne borne i cili ka shkaktuar rritjen e rezistences dhe kjo është burim i shkundjes se pare te zjarrit ne lokalin e lartcekur. Nga kjo baze e paditura është përgjegjëse për kompensimin e demit sepse merret me ushtrimin e veprimtarisë se rrezikshme konform nenit 170. 1 dhe nen.174.1 te LMD, .ku e paditura si operatore e bartes është e obliguar ne mirëmbajtjen e rrjetit zhvillimin e tij etj. Sa i përket lartësisë se demit te shkaktuar ne pasurinë – gjësendet e tani paditësit gjykata e vërtetoi nëpërmjet te ekspertit financiar Mr.Sc M.F.nga se i njëjti konstatim është ne mase te mjaftuar i arsyetuar dhe argumentuar si dhe i mbështetur edhe ne sqarimet te cilat i dha ne seancën e shqyrtimit kryesor ku është konstatuar dhe vlerësuar se demi material ne gjësendet dhe orendit shtëpiake si pasoj e zjarrit te shkaktuar është ne shume prej 158.234,00Euro.

Ne fund Gjykata e shkalles së parë ka theksuar se vlerësoi pretendimin e te paditurës sa i përket parashkrimit te kërkesëpadisë si dhe kompetencën e kësaj gjykate dhe si te tille e refuzoi si te pabazuar e me qellim te shmangej nga përgjegjësia dhe obligimi i kompensimit te demit te shkaktuar nga se e paditura është përgjegjëse për kompozimin e demit sepse merret me ushtrimin e veprimtarisë se rrezikshme konform nenit.154,170.1,174.1, te LMD, ku e paditura si operatore e bartjes është e obliguar ne mirëmbajtjen e rrjetit ,zhvillimin e tij, prandaj e paditura është dashur te kujdeset për furnizim kualitativ dhe perqimin kualitativ te rrymës nga baza e saj deri te konsumatori, ndërsa sa i përket parashkrimit gjykata vlerëson si te pabazuar, sepse kërkesa e paditësit për shpërblimin e demit rrjedh nga baza e kompensimit te demit me vepër penale , nga se demi është shkaktuar me vepër penale ku arsyetohet nga Aktakuza e sipërcekur dhe për kompensimin e demit – parashkruhet kur te skadoj koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale dhe se ndërprerja e parashkrimit te ndjekjes penale sjelle edhe ndërprerjen e parashkrimit te kërkesës për shpërblimin e demit. Andaj kërkesa për shpërblimin e demit parashkruhet kur te skadoj koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale, konform nenit 377 LMD (vjeter) .

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkalles së parë, rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejt dhe i ligjshëm, pasi që

aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 pika 4 dhe 5 të LPK-së. Gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka ka ardhur edhe gjerë tek zbatimi apo aplikimi i gabuar i së drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadsisë. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka përshtetje të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi themelësinë e kërkesëpadsisë.

Gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadsisë, edhe pse në këtë rast gjykata e shkallës së parë për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadsisë ka administruar si provën me ekspertim nga lëmia e elektros e cila është nxjerr ne procedurë penale, e konstatimet e ekspertit në këte ekspertizë janë të paqarta, jo të plota, kontradiktore dhe në kundërshtim në vetvete dhe në kundërshtim me rrethanat e shqyrtuar dhe provat e administruara, për arsyes se eksperti nuk ka konstatuar se cilat janë konkretisht lëshimet nga ana e të paditurës me rastin e shpërthimit të zjarrit.

Pasi që në ankese nder të tjera pretendimet e paditurës janë në raport me parashkrimin të kërkesës, Gjykata Apelit e Kosovës vlerëson se lidhur me parashkrimin e kërkesëpadsisë në kontestet që kanë të bëjnë me parashkrimin e kërkesës lidhur me kompensimin e dëmit, gjykata i shqyrton gjithëherë sipas prapësimit të palës, prandaj në këtë rast e paditura, ka paraqitur pretendim lidhur me parashkrimin e kërkesës ndaj saj, me pretendimin se ka kaluar afati i parashkrimit. Gjykata Apelit e Kosovës, i ka vlerësuar me kujdes pretendimet e paditurës të paraqitura, dhe të njëjtat janë të bazuara, për faktin se afatet e përcaktuara me nenin 376 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 377 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), janë afate të përcaktuara, dhe të njëjtat afate nuk mund të zgjaten dhe as të shtyhen, dhe se në rast të kalimit të afatit, kërkesa arrin parashkrimin, ndërsa gjykata sipas prapësimit të palës e vlerëson nëse kërkesa është e parashkruar ose jo, e që në këtë rast gjykatat e shkallës së parë nuk e kanë vërtetuar **saktë faktin** nëse kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, për arsye se: Me nenin 376 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet prë tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin ”, ndërsa në paragrafin 2, përcaktohet se: “Sidoçoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi ”. Me nenin 377 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale ”. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, për faktin se e njëjta nuk ka arritur të japin arsye

lidhur me faktet vendimtare rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, për arsye se: në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk e kanë vërtetuar faktin nëse kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesëpadisë së paditësit. Gjykatat e shkallës së parë nuk e kanë vërtetuar faktin nëse ndaj shkaktarit të aksidentit është ka përfunduar procedura penale ose jo. Në shkresat e lëndës kemi vetëm një aktakuz të lëshuar nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1325/2018 të datës 10.01.2019, në drejtim të veprës penale shkaktim i rrezikut të pergjitheshum nga neni 365 paragrafi 4, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, mirëpo nuk kemi të dhëna tjera nëse është vazhduar më tutje me procedurë penale ose jo. Nga aktakuza nuk mund të konstatohet fakti nëse ka filluar procedurë penale në gjykatë dhe nëse është filluar në cilën fazë të procedurës gjendet. Gjykata e Apelit, vlerëson se nëse kemi inicim të procedurës penale dhe ende nuk kemi ndonjë aktgjykim të formës së prerë lidhur me këtë çështje, atëherë për parashkrimin e kërkesës së paditësit vlejné dispozitat e parashkrimit të veprës penale, ashtu siç është paraparë me dispozitën ligjore nga neni 358 të LMD-së, sepse është determinuese për gjykatën të konstatoj nëse pala e dëmtuar është në njohuri për dëmin dhe shkaktarin e dëmit dhe si pasojë e mos veprimit në këtë drejtim, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, ku përveç të cekurave gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj ka bërë shkelje dispozitave të lartcekura të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, duke vlerësuar të gjitha kushtet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit dhe nëse konstaton se plotësohen kushtet për zhvillimin e shqyrtimit të caktojë seancën përgatitore apo drejtpërdrejtë të shqyrtimit kryesor (varësisht nga vlerësimi i gjykatës për nevojën e seancës përgatitore) dhe sipas propozimit të palëve, të administrojë provat për vërtetimin e fakteve vendimtare, atë mënyrë që fillimisht të konstatoi se në këtë rast a është kontestuese baza juridike sa i përket shkakut të shpërthimit të zjarrit, nëse edhe me tej mbetet kontestuese baza juridike sa i përket shkakut të zjarrit, ta caktoj nxjerrjen e provës nga lëmia e elektros, ta ftoj ekspertin për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e dhënë në ekspertizë, pastaj ti marr në shikim shkresat penale nëse është e nevojshme ti kërkojë sipas detyrës zyrtare, dhe pas kësaj gjykata të ndërmer hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me neni 160 të LPK-së.

Gjykata shkallës së parë në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195.1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 843/2021, me datë 11.06.2024

Kryetari i kolegjit
Naim Mehulli, d.v